



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore
Me datë 27.12.2022

Vendimet për DISKUTIM PUBLIK					
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
1	Rrahman Brava	Mës. Gjeografi	Përshtatshmëria e teksteve të gjeografisë për klasën e XII për realizimin e kompetencës së të menduarit sipas kurrikulës bërthamë në shkollën e mesme të lartë	Kryetar/e	Florim Isufi
				Mentor/e	Nusret Pllana
				Anetar/e	Hatixhe Ismajli
2	Gabriell Simoni	Mës. Biologji	Ndikimi i strategjisë së leximit në arritjen e rezultateve të nxënimit e Biologjisë	Kryetar/e	Zeqir Veselaj
				Mentor/e	Ruzhdi Kuqi
				Anetar/e	Hatixhe Ismajli
3	Elmedina Durguti	Mës. Matematikë	Ndikimi i mësimin në distancë në arritjet e nxënësve në lëndën e matematikës	Kryetar/e	Fahri Marevci
				Mentor/e	Eda Vula
				Anetar/e	Kyvetë Shatri
4	Fjolla Osmanaj	Mës. Biologji	Përfshirja procentuale e pyetjeve të testeve në biologji, sipas niveleve të taksonomisë së Bloom-it në shkollën e mesme të ulët	Kryetar/e	Zeqir Shaqiri
				Mentor/e	Ruzhdi Kuqi
				Anetar/e	Jehona Ferizi Miftari
5	Selvete Abdullahu	Mës. Gjeografi	Roli i vlerësimit në përmirësimin e rezultateve të të nxënimit në lëndën e Gjeografisë në SHFMU të Komunës së Podujevës	Kryetar/e	Arsim Ejupi
				Mentor/e	Nusret Pllana
				Anetar/e	Bahtije Gërbeshi
6	Xhuljeta Hysenaj	Mës. Biologji	Qëndrimet dhe njohuritë e nxënësve të shkollës së mesme të lartë për burimet e ripërtëritshme të energjisë	Kryetar/e	Ruzhdi Kuqi
				Mentor/e	Zeqir Veselaj
				Anetar/e	Sylejman Berisha
7	Adelina Sylja	Mës. Histori	Rëndësia e përdorimit të atlasëve historikë në përmirësimin e të nxënimit e Historisë tek nxënësit e klasës së VIII	Kryetar/e	Bahtije Gërbeshi
				Mentor/e	Sedat Baraliju
				Anetar/e	Vlora Sylaj

Kandidati/ja: 1. Rrahman Brava

Tema: Përshtatshmëria e teksteve të gjeografisë për klasën e XII për realizimin e kompetencës së të menduarit sipas kurrikulës bërthamë në shkollën e mesme të lartë

ABSTRAKT

Pavarësisht zhvillimit të hovshëm të teknologjisë në vitet e fundit, libri vazhdon të mbetet mjeti kryesor dhe më i përdorur në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Libri është burimi më i besueshëm dhe një lloj “pushteti absolut” për mësimdhënësit dhe nxënësit. Nisur nga kjo, studiuesit janë përpjekur të zhvillojnë korniza/qasje për të vlerësuar sa librat janë efektivë dhe të përshtatshëm për të zhvilluar shkathtësitë dhe kompetencat e nxënësve. Kompetenca e të menduarit, konsiderohet si kompetenca kryesore në kurrikulat e shumë vendeve, për arsyen se ajo ndihmon për zhvillimin e kompetencave të tjera. Kësisoj, interesi për të hetuar përputhshmërinë e teksteve shkollore me këtë kompetencë, është rritur vazhdimisht në vitet e fundit.

Qëllimi kryesor i këtij punimi të masterit ka qenë të vlerësohet nga prizmi i një kornize shkencore, se sa është libri i Gjeografisë për klasën XII i përshtatshëm për zhvillimin e kompetencës së të menduarit, si një prej shtatë kompetencave në Kurrikulën Bërthamë të Kosovës. Për këtë qëllim është përdorur korniza e propozuar nga Ambarëati et al. (2020) e cila përbëhet prej tri kriterëve: lexueshmëria e tekstit, azhurnimi i informacionit dhe përmbajtja kontekstuale. Kriteri i fundit mat në mënyrë të drejtpërdrejtë se sa aktivitetet e librit mbështesin zhvillimin e kompetencës së menduarit, duke parë fjalët kyçe që përdoren në këto aktivitete. Fjalët kyçe të kësaj kompetence janë: analizë, sqarim, gjykim, interpretim, sqarim, vlerësim, argumentim dhe zbatim. Në hulumtim janë realizuar edhe intervista gjysmë të strukturuar me mësimdhënësve të Gjeografisë për të kuptuar sa ata kanë njohuri për këtë kompetencë, sa mendojnë se libri ndihmon në zhvillimin e kësaj kompetence dhe nëse atyre iu duhet të përdorin materiale shtesë për të mundësuar zhvillimin e kompetencës.

Rezultatet treguan se 90% e aktiviteteve të librit janë të nivelit riprodhim i informacionit dhe vetëm 10% e tyre kontribuojnë në zhvillim të kompetencës së të menduarit. Libri ka probleme të theksuara didaktike si: vjetërsia e informacionit, mungesa e objekteve vizuale që shoqërojnë tekstin, paragrafët e ngarkuara që pengojnë zhvillimin e kompetencës së të menduarit.

Fjalët kyçe: përshtatshmëria, teksti, Gjeografia, kompetenca, menduarit, kurrikula

Kandidati/ja: 2. Gabriell Simoni

Tema: Ndikimi i strategjisë së leximit ne arritjen e rezultateve te të nxënit e Biologjisë

ABSTRAKTI

Me anë te strategjive të leximit, mësimdhënesit vetëdijesohen per mësimet qe do të realizojnë si dhe për pritshmeritë dhe arritjet e rezultateve te të nxenit nga ana e nxënësve, ndërsa nxënësit nga leximi përfitojnë dije, përforcim te njohurive, si dhe zgjerim te njohurive ekzistuese.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të tregoj ndikimin qe kanë strategjitë e leximit ne arritjen e rezultateve te të nxenit, me fokus ne biologjinë si lëndë. Mbledhja e informacionit për këtë hulumtim eshte realizuar, duke shfrytëzuar literaturën bashkëkohore si dhe grumbullimin e materialit përmes hulumtimit ne internet.

Qasja sasiore dhe cilësore jane miratuar në këtë studim. Të dhënat e studimit jane mbledhur nga para-testi dhe pas-testi për temën e caktuar, ky hulumtim u realizoua ne shkollen e mesme te ultë “Dardania” ne Prishtinë ku si mostër e hulumtimi ishin gjithsej 50 nxënës, 25 nxënës nga dy paralele , ku njëra klase ishte grupi kontroll e tjetra klase ishte grupi experimental, të cilat na mundësojnë t’i grumbullojmë të dhënat, analizojmë, krahasojmë dhe të tregojmë nivelin e këtij hulumtimi më konkretisht.

Në fund të punimit janë paraqitur rezultatet e hulumtimit, si dhe jepen rekomandime për hulumtime te ngjajshme në të ardhmen. Sipas rezultateve te përpunuara, verejmë se nxenësit e klasës experimentale, me te cilët kam perdorur strategji te leximit, kanë dukshëm te nxënë me të mirë se sa klasa kontrollë ne të cilen nuk kam përdorur asnjë strategji te leximit, për më tepër edhe motivimi i mësimdhënësit ka shumë rëndesi ne mënyrën se si nxenësit mësojnë dhe reflektojnë. Ky hulumtim mund t’ju ndihmojë mësimdhënesve ne perdorimin me efikas dhe të duhur të strategjive të leximit.

Fjalët kyçe: Biologjia, Mësimdhënie, Nxënësi, Nxënie, Strategjitë

Kandidati/ja: 3. Elmedina Durguti

Tema: Ndikimi i mësimit në distancë në arritjet e nxënësve në lëndën e matematikës

ABSTRAKTI

Mësimi në distancë është një nga format e mësimit në të cilën nxënësit jo gjithmonë mund të jenë fizikisht të pranishëm në një shkollë apo institucion arsimor. Gjatë kësaj forme të mësimdhënies burimi i informacionit dhe nxënësit janë të ndarë nga koha apo distanca ose të dyjat. Kjo formë e të mësuarit zakonisht praktikohet me përdorimin e teknologjive të ndryshme të komunikimit për të rritur aftësitë e mësimdhënësve dhe nxënësve për të komunikuar me njëri tjetrin.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizuarit se cila formë e të mësuarit ajo ballë për ballë apo në distancë sjell rezultate më të mira të nxënësve në lëndën e matematikës, veçanërisht të analizoj ndikimin e përdorimit të platformave elektronike gjatë mësimit në distancë në arritjet e nxënësve. Po ashtu hulumtimi ka analizuar perceptimet e nxënësve për mësimin në distancë, konkretisht të kuptuarit e ndikimit të platformave elektronike Zoom dhe Google Classroom në arritjet e nxënësve në zgjidhjen e detyrave problemore që kërkonin zbatimin e vargut aritmetik dhe gjeometrik.

Metodologjia e hulumtimit është hulumtim në veprim me dizajnin kuazi eksperimental. Hulumtimi u zhvillua në shkollën e lartë profesionale “Selajdin Mullaabazi- Mici” në Rahovec, ku pjesëmarrës ishin 30 nxënës të dy klasave të 12-ta të profilit të mjekësisë. Të dhënat u mblodhën nga paratesti, pastesti dhe pyetësi. Në grupin eksperimental është zhvilluar intervenimi, me kalimin e mësimit nga forma ballë për ballë në formën e mësimdhënies në distancë, ndërsa në grupin kontroll ka vazhduar mbajtja e mësimit në formën ballë për ballë. Pas intervenimit prej katër javëve është mbajtur pastesti tek dy grupet. Ndërkaq për të kuptuar mbi perceptimet e nxënësve për mësimin në distancë është përdorur një pyetësor me grupin eksperimental. Rezultatet e hulumtimit treguan se forma e mësimdhënies në distancë me përdorimin e platformave Zoom dhe Google classroom ka rezultuar më e suksesshme se forma e mësimdhënies ballë për ballë. Po ashtu rezultatet treguan se nxënësit kanë perceptime pozitive rreth mbajtjes së mësimit në distancë ku pohuan se kjo formë e të mësuarit ka ndikuar që të jenë më të vetëdijshëm mbi përmbajtjen e matematikës si dhe ka ndikuar në arritjet e tyre në të kuptuarit e vargjeve numerike.

Fjalët kyçe: mësim në distancë, mësimi ballë për ballë, platformat elektronike, vargjet numerike, arritjet

Kandidati/ja: 4. Fjolla Osmanaj

Tema: Përfshirja procentuale e pyetjeve të testeve në biologji, sipas niveleve të taksonomisë së Bloom-it në shkollën e mesme të ulët

ABSTRAKTI

Vlerësimi i nxënësve është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. Testi është instrument vlerësimi shumë i përdorur për të matur njohuritë dhe aftësitë e nxënësve. Pyetjet e testit përdoren për të marrë informacion, për të stimuluar të menduarit dhe ridrejtuar arsyetimin. Prandaj për të nxitur të nxënësve kreativ dhe kritik, për të matur aftësitë e ndryshme të nxënësve testi duhet të përmbajë pyetje me nivele të ndryshme vështirësie. Këto nivele të ndryshme vështirësie të fushës njohëse i përmban taksonomia e Bloom-it. Pra për përpilimin e testeve duhet të përdoret kjo taksonomi dhe nivelet e ndryshme që posedon ajo. Por, cili është raporti procentual i pyetjeve sipas taksonomisë së Bloom-it të përdorur nga mësimdhënësit e Biologjisë? Kështu rrjedh edhe definimi i problemit të këtij hulumtimi.

Pyetja kryesore e këtij hulumtimi është: Cili është raporti procentual i pyetjeve sipas niveleve të taksonomisë së Bloom-it në testet e biologjisë? Kurse pyetja ndihmëse është: Sa është ndryshimi procentual i pyetjeve të niveleve të ulta dhe atyre të larta të taksonomisë së Bloom-it në testet e biologjisë?

Hipoteza e këtij hulumtimi është: Shpërndarja procentuale e pyetjeve sipas niveleve të taksonomisë së Bloom-it nuk do të jetë e njëtrajtshme, kurse nënhipoteza është që pjesëmarrja procentuale e pyetjeve të niveleve të ulta është më e madhe se e pyetjeve të niveleve të larta të taksonomisë së Bloom-it.

Për këtë hulumtim të përzier-miks është bërë analizimi i dokumenteve. Si dokumente përdoren testet e formuluar nga mësimdhënësit e biologjisë për klasët e gjashta deri tek klasët e nënta, gjatë vitit shkollor 2021-2022. Janë analizuar gjithsej 55 teste nga disa shkolla të mesme të ulta të komunës së Istogut. Mostra e zgjedhur për këtë hulumtim janë 7 mësimdhënës të biologjisë.

Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë shpërndarje procentuale jo të njëtrajtshme të pyetjeve sipas niveleve të taksonomisë dhe se pjesëmarrja procentuale e pyetjeve të niveleve të ulta është më e madhe se e pyetjeve të niveleve të larta të taksonomisë së Bloom-it.

Fjalët kyçe: Biologji, mësimdhënës, përqindje, taksonomi, teste.

Kandidati/ja: 5. Selvete Abdullahu

Tema: Roli i vlerësimit në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve në lëndën e Gjeografisë në SHFMU të Komunës së Podujevës

ABSTRAKTI

Përderisa në mësimdhënien tradicionale vlerësimi ishte bërë me ndihmën e 2-3 instrumenteve, sot në mësimdhënien bashkëkohore kemi mundësi të shumta se si t'i vlerësojmë nxënësit. Kjo duke i'u referuar stileve të ndryshme të të nxënësve të tyre në kuadër të vlerësimit të vazhdueshëm gjatë procesit mësimorë, por edhe atij përmbledhës që bëhet në fund të periodës. Me qenë se mësimdhëniet bashkëkohore është e bazuar në kompetenca, atëherë mësimdhënësi i ditëve të sotme duhet të fokusohet që me nxënësit t'i arrijnë rezultatet e kompetencave përmes vlerësimit.

A po arrihen këto rezultate apo jo, me anën e vlerësimit, ishte edhe ideja e këtij hulumtimi. Në kuadër të këtij punimi janë përfshirë kryesisht qëllimi i hulumtimit, hipotezat dhe pyetjet të cilave kemi synuar t'u gjejmë përgjigje përmes këtij studimi. Shqyrtimi i literaturave të ndryshme duke përfshirë dokumente zyrtare të cilat e rregullojnë vlerësimin si proces, udhëzimet administrative dhe studime nga autorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.

Këtij studimi kemi menduar t'i qasemi me anën e metodës së përzier ku përfshihet edhe mostra populacionin e së cilës e kanë përbërë nxënësit e shkollave fillore të mesme të ulëta të Komunës së Podujevës, dhe mësimdhënësit e gjeografisë. Analizimi i informacionit të siguruar nga instrumentet për mbledhjen e tyre, është bërë përmes programit SPSS, ndërsa paraqitja e tyre është bërë në mënyrë grafike e numerike.

Fjalët kyçe: Korniza kurrikulare, Vlerësimi Formativ, Vlerësimi përmbledhës, Rezultatet e të nxënësve.

Kandidati/ja: 6. Xhuljeta Hysenaj

Tema: Qëndrimet dhe njohuritë e nxënësve të shkollës së mesme të lartë për burimet e ripërtëritshme të energjisë

ABSTRAKTI

Si burime të ripërtëritshme të energjisë, konsiderohen të gjitha ato burime që në natyrë shfaqen në forma të ndryshme dhe janë të pashtershme, do të thotë rigjenerohen vazhdimisht. Burimet e ripërtëritshme të energjisë janë duke përjetuar një periudhë të hovshme të zhvillimit të tyre në nivel botëror dhe janë duke kontribuar dukshëm në rritjen e prodhimit të energjisë. Disa prej shteteve të zhvilluara industriale, një pjesë të konsiderueshme të furnizimit të tyre me energji elektrike e mbulojnë pikërisht nëpërmjet diversifikimit të burimeve, respektivisht nëpërmjet përdorimit të energjive të ripërtëritshme nga uji, biomasa, dielli, era, gjeotermia etj. Mungojnë të dhënat për njohuritë e nxënësve për energjinë e ripërtëritshme.

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë grumbullimi dhe analizimi i të dhënave për njohuritë e nxënësve për energjinë e ripërtëritshme. Pyetja kryesore e hulumtimit ishte se: a keni informacione për energjinë e ripërtëritshme në vendin tonë? Për të realizuar këtë studim, metoda për grumbullimin e të dhënave është metoda kuantitative. Instrumenti matës për mbledhjen e të dhënave sasiore është përpiluar në formë të pyetësorit, i cili është realizuar me një mostër prej 150 nxënësve të shkollës së mesme të lartë (të klasave të XII-ta), në gjimnazin “Eqrem Çabej”, komuna e Vushtrrisë. Përmes qëndrimeve dhe njohurive të nxënësve janë analizuar se sa janë të përfshira temat e energjisë së ripërtëritshme në tekstet shkollore, dhe sa janë të zbatuara këto burime të energjisë në shkollat e Vushtrrisë.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se nxënësit kanë njohuri për energjinë e ripërtëritshme, mirëpo, këto njohuri kryesisht i marrin nga burime të tjera të informacionit dhe pak prej tyre nga shkolla. Edhe mungon zhvillimi i aktiviteteve me nxënës në lidhje me këtë temë.

Fjalët kyqe: Energjia e ripërtëritshme, nxënësit, njohuritë, qëndrimet

Kandidati/ja: 7. Adelina Syla

Tema: Rëndësia e përdorimit të atlasëve historikë në përmisimin e të nxënësve të Historisë tek nxënësit e klasës së VIII

ABSTRAKTI

Hartat janë mjete thelbësore në jetën moderne, por ato janë gjithashtu dokumente burimore kryesore që pasqyrojnë njerëzit, kohën dhe kulturën që i kanë prodhuar ato. Ato mund të lexohen në nivele të ndryshme dhe të përdoren për qëllime të ndryshme. Sidoqoftë, në çdo rast, disa baza të të mësuarit social mund të vihen në fokus kur një klasë shikon me kujdes një hartë të vetme. Shkrim-leximi vizual, analiza kritike, të mësuarit sintetik dhe të menduarit ndërdisiplinor të gjitha hyjnë në lojë. Por, hartat janë shpesh shumë të mëdha për t'u përdorur në tavolinat e studentëve. Pra, një aktivitet i tabelës së buletinit i bazuar në prerjen e hartës në seksione të menaxhueshme - një strategji "përça dhe sundo" - ofron një rrugëdalje. Nëse harta nuk është shumë e madhe, zmadhimi i saj në një makinë kopjimi për të sqaruar detajet e saj shpesh do të rrisë vlerën e saj pedagogjike. Metodot dhe teknikat të cilat do ti përdor për të realizuar këtë punim, kanë të bëjnë me kriteret me të cilat do të ndjekë në përzgjedhjen e literaturës. Mikse (e përzier), sasore dhe cilësore, bazuar në qëllimet dhe pyetjet, pa përjashtuar edhe metodën e analizës teorike dhe statistikore. Sa i përket instrumenteve do të përdorë pyetësorin të cilin do ta realizojë me nxënësit e shkollave të mesme të ulëta në katër shkolla fillore të mesme të ulëta në komunën e Vushtrisë. Pyetjet kërkimore janë: Sa përdorin nxënësit e klasës së VIII atlaset e historisë? Sa ju ndimojnë nxënësve atlaset e historisë? A ju bëjnë më atraktive orën mësimore përdorimi i atlasëve historike në lëndën e historisë?. Qëllimi i hulumtimit. Qëllimi i këtij hulumtimi është hulumtimi i impaktit që kanë atlaset historike në përmisimin e rezultateve të të nxënësve të nxënësve në lëndën e historisë. Hipotezat e hulumtimit:

H1: Atlaset e historisë ndimojnë nxënësit në arritjen e rezultateve më të mira në lëndën e historisë.

H2: Atlaset e bëjnë lëndën e historisë më atraktive për nxënësit. Niveli i klasëve në të cilët do të zhvillohet hulumtimi janë klasët VIII nga shkollat e mesme të ulëta . Do të realizojmë pyetësor me nxënës dhe intervista me mësimdhënësit e lëndës së historisë.

Hulumtimi do të jetë i dobishëm për nxënësit, mësimdhënësit, dhe për opinionin e gjerë. Njohuritë e fituara gjatë këtij hulumtimi do mundohemi t'i transmetojmë të nxënësitë, mësimdhënësit, rrethi ku jetojmë dhe punojmë. Në bazë të rezultateve do të dalin dhe çështje tjera për hulumtim.

Fjalët kryesore (kyçe): Histori ,Atlas , Ndikim, të nxënësve